



02/02/2022

Shkodër – Kontrolle blic në të gjithë qarkun, vihen në pranga 4 shtetas

Vijojnë kontrollet blic në të gjithë qarkun, për parandalimin dhe goditjen e armëmbajtjes pa leje, kapjen e personave në kërkim dhe të atyre që shpërndajnë lëndë narkotike.

Si rezultat i kontrolleve është kapur dhe arrestuar në flagrancë një shtetas që qarkullonte me armë zjarri në automjet.

Gjithashtu, janë arrestuar në flagrancë 3 shtetas të tjerë, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Në vijim të kontrolleve blic për parandalimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, kapjen e personave në kërkim dhe të atyre që shpërndajnë lëndë narkotike, nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve dhe Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër u kap dhe u arrestua në flagrancë shtetasi:

A. Gj., 24 vjeç, banues në fshatin Prekal, Shkodër.

Shërbimet e Policisë kanë konstatuar dhe ndaluar në fshatin Golem, Shkodër, mjetin tip “Benz” me drejtues shtetasin A. Gj. Gjatë kontrollit të ushtruar në mjet është gjetur e fshehur një armë zjarri automatike, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale

Gjithashtu, gjatë kontrolleve të ushtruara në qytetin e Shkodrës, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër janë arrestuar në flagrancë shtetasit:

M. C., 19 vjeç, banues në fshatin Grudë, Malësi e Madhe; M. L., 22 vjeç dhe A. G., 17 vjeç, të dy banues në fshatin Grudë e Re, Shkodër.

Këta shtetas janë konstatuar nga shërbimet e Policisë, në lagjen “Skënderbeg”, duke bërë lëvizje të dyshimta me mjetin “Volkswagen”. Pas ndalimit, gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj këtyre shtetasve dhe kontrollit të automjetit u gjet një sasi lëndë narkotike cannabis sativa.

U sekuestruan në cilësinë e provës materiale lënda narkotike, mjeti tip “Volkswagen” dhe 3 aparate celulare.

Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

WhatsApp Share

Facebook Share

Twitter Share

LinkedIn Share

Email

◀ Tiranë – Vihen në pranga 11 shtetas, 4 prej tyre të shpallur në kërkim, dhe procedohet penalisht 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale

Durrës – Vihen në pranga 2 shtetas, për vepra të ndryshme penale ▶